



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 435/Prot  
4

Tiranë, më 15.06.2016

VENDIM

Nr. 28, datë 15.06.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit *Spitali Rajonal Shkodër*, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 95, datë 08.04.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 18.04.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit i përbërë nga \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit *Spitali Rajonal Shkodër*, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit *Spitali Rajonal Shkodër*, i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesi i kontrolluesit, i cili ishte njohur me Urdhrin nr.95, datë 08.04.2016, të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohet pranë këtij kontrolluesi.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi ka një rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e spitalit, ku janë përshkruar detyrat e secilit punëmarrës, por nuk ka rregullore apo rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale-pacientë.
2. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit "Deklaratën e Konfidencialitetit". Konstatohet se ruajtja e konfidencialitetit nuk parashikohet as në kontratën e punës të punëmarrësit;
3. Konstatohet se kontrolluesi ka një sistem video-survejimi (CCTV), i cili administrohet nga punonjësit e brendshëm të teknologjisë dhe informacionit. Konstatohen tabela

informuese në hyrje të ambienteve të mbikëqyruara, por jo sipas formatit standard të miratuar në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

**Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe akteve të Komisionerit.**

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverballi i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Kontratë me punëmarrësin;
- Kontratë kolektive;
- Rregullore bazë e funksionimit të *Spitalit Rajonal Shkodër*;
- Pamje/foto nga ambientet e kontrolluesit dhe sistemi CCTV;
- Formular Njoftimi.

Në datë 11.05.2016, u mbajt procesverbal nga ana e grupit të inspektimit të Zyrës së K.D.I. M.D.P-së, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit *Spitali Rajonal Shkodër*, në zbatim të kërkesave të Urdhrit nr.95, datë 08.04.2016 të Komisionerit.

Procesverbali pasi u lexua nga të pranishmit ju dorëzua përfaqësuesit të kontrolluesit, i cili nuk paraqiti pretendime me shkrim, por u shpreh se do i paraqiste ato në seancën dëgjimore.

Në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, datë 30.04.2015, në datë 13.06.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, është organizuar seanca dëgjimore. Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk u paraqitën, por as nuk kanë depozituar pranë KDIMDP-së pretendime në formë verbale.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma “dh” e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, janë serioze për vetë faktin e përmasës së kontrolluesit, (Spital Rajonal), gamës së të dhënave sensitive që ky kontrollues mbledh e përpunon. Si të tilla këto shkelje përbëjnë “kundërvajtje administrative”, dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

“- dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.”

Kontrolluesi, *Spitali Rajonal Shkodër*, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe primeve bazë të mbrojtjes së të



dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave "pacientë".

### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 28, 39 paragrafi 1, gërma "dh", si dhe nenit 39, paragrafi 2 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit *Spitali Rajonal Shkodër*, me gjobë në vlerën **100.000 (njëqind mijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit *Spitali Rajonal Shkodër*, me gjobë në vlerën **100.000 (njëqind mijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi, *Spitali Rajonal Shkodër*, të hartojë rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, të realizojë pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013, brenda një periudhe prej 30 ditësh.
4. Kontrolluesi, *Spitali Rajonal Shkodër*, të realizojë standartizimin e tabelave të informimit, konform aktit të Komisionerit Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 15.06.2016

